



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

OPINION

MBI

KANDIDATEN ZNJ. {...}, E CILA KA APLIKUAR PËR T'U KOMANDUAR SI
NDIHMËSMAGJISTRATE PRANË GJYKATËS SË LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “ë”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në shkronjën “a”, pika 2, të nenit 61, në shkronjën “d” të nenit 86, në shkronjë “b”, pika 1, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54, 56, 57 dhe 58, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe pikën 4, të nenit 34, të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, mbi kërkesën e Gjykatës së Lartë, sipas Shkresës nr. 1607 prot., datë 17.07.2020 dhe shkresës nr. 1607/1 prot., datë 20.07.2020, me vendimin nr. 258 datë 23.07.2020 ka vendosur:

- 1. Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë.*
- 2. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Gjykatën e Lartë, për pesë pozicione të lira si “ndihmësmagjistrat”.*
-
- 3. Afati i paraqitjes së kërkesës për komandim është deri më datë 04.09.2020.*

Brenda afatit të paraqitjes së kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka paraqitur kërkesë znj. Erlanda Agaj, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Në nenin 54, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me procedurën e komandimit, ndër të tjera parashikohet se: “Këshilli, brenda dy javëve pas afatit të aplikimit, përgatit një opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ose prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin. Opinioni për çdo kandidat publikohet në faqen zyrtare të Këshillit. Kandidati, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ose prokurorisë, përjashtohet nga komandimi. Këshilli, brenda dy javëve pas afatit të kandidimit, i dërgon institucionit në të cilin do të bëhet komandimi emrat e kandidatëve që plotësojnë kriteret e pozicionit përkatës...”

Në respektim të këtij parashikimi ligjor, lidhur me vlerësimin e Këshillit, bazuar në pikën 11 të vendimit nr. 258 datë 23.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me procedurën e komandimit, ndër të tjera parashikohet se: “Brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të kandidimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinione të miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli vendos përjashtimin e kandidatit nga komandimi kur komandimi nuk është në

përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit?

Nga informacioni i marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, si dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier rezultoi se : “Kjo gjykatë ka në organikë 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë por efektivisht ushtrojnë detyrën 9 (nëntë) gjyqtarë. Gjyqtari Alfred Konomi deri më datë 31.08.2020 ka gjykuar 317 çështje, por aktualisht ka në proces gjykimi 158 çështje. Gjyqtarja {...} deri më datë 31.08.2020 ka gjykuar 257 çështje, por aktualisht ka në proces gjykimi 156 çështje. Gjyqtari {...} deri më datë 31.08.2020 ka gjykuar 309 çështje, por aktualisht ka në proces gjykimi 175 çështje. **Gjyqtarja {...} deri më datë 31.08.2020 ka gjykuar 172 çështje, por aktualisht ka në proces gjykimi 104 çështje.** Gjyqtarja {...} deri më datë 31.08.2020 ka gjykuar 273 çështje, por aktualisht ka në proces gjykimi 114 çështje. Gjyqtarja {...} deri më datë 31.08.2020 ka gjykuar 173 çështje, por aktualisht ka në proces gjykimi 81 çështje. Gjyq {...} Lice deri më datë 31.08.2020 ka gjykuar 293 çështje, por aktualisht ka në proces gjykimi 116 çështje. Gjyqtari {...} deri më datë 31.08.2020 ka gjykuar 275 çështje, por aktualisht ka në proces gjykimi 176 çështje. Gjyqtari Taulant Banushi deri më datë 31.08.2020 ka gjykuar 274 çështje, por aktualisht ka në proces gjykimi 99 çështje”.

Rezulton se gjyqtarët {...} dhe {...} janë aktualisht me leje lindje; gjyqtari {...} shërben si ndihmës magjistrat pranë Gjykatës së Lartë; gjyqtari {...} është i pezulluar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor; ish gjyqtari {...} është shkarkuar me vendimin nr. 150, datë 28.05.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lënë në fuqi Kolegji i Posaçëm i Apelimit; gjyqtarja {...} me vendimin nr.317, datë 16.09.2020 është komanduar në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për një afat deri në një vit.

Rezulton gjithashtu se me shkresën nr. 4356 prot, datë 15.09.2020, gjyqtarja {...} ka paraqitur një kërkesë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për t’u përfshirë në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit e në këto kushte mund të jetë një kandidatë potenciale për t’u pranuar në këtë skemë, duke konsideruar situatën e nevojave të gjykatave aktualisht. Në rastin hipotetik të pranimit të kësaj gjyqtareje në skemën e delegimit, numri i gjyqtarëve të kësaj gjykate do të shkonte në 8 gjyqtarë.

Në respektim të përcaktimit të bërë në pikën 4, të nenit 54, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, lidhur me vlerësimin e Këshillit, nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidatja ushtron funksionin, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës çmon se, në rastin konkret, komandimi i kësaj gjyqtareje vjen ndesh me interesat e larta të gjykatës ku ajo ushtron funksionin.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar se:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier nuk funksionon me organikë të plotë pasi funksionin e gjyqtarit në këtë gjykatë aktualisht e ushtrojnë 9 gjyqtarë;
- Faktin që ngarkesa e kësaj gjykate rezulton të jetë e lartë. Nga të dhënat e cituara më sipër rezulton që gjyqtarët e kësaj gjykate kanë në gjykim një mesatare çështjesh prej 150 çështje për gjyqtarë.
- Faktin që një nga gjyqtarët e kësaj gjykate, znj. {...} është kandidatë potenciale për t’u përfshirë në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit

vlerëson se, komandimi i znj. {...}, si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë, cenon interesat e larta të kësaj gjykate për shkak se cenohet funksionaliteti i saj, bazuar në shkaqet e cituara në këtë relacion.

Bazuar sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

- *Përfashtimin e kandidates znj. {...}, nga procedurat e komandimit si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë.*
- *Publikimin e këtij opinioni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*

KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS